



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 7926 Prot.

Durrës, më 27.06.2025

U R D H Ë R

Nr. 177 DATË 27/06/2025

**MBI ORGANIZIMIN E PLANIT TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE NË
BULEVARDIN EPIDAMN DUKE FILLUAR NGA DATA 01.07.2025 DERI MË DATË
31.08.2025**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 11 pika 3 shkronja “ç”, nenit 44 shkronja “a”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Kufizimin e qarkullimit të automjeteve për periudhën 01.07.2025–31.08.2025, për mbarëvajtjen e sezonit turistik, përgjatë rrugës Epidamn (Segmenti rrugor nga Prefektura deri te Torra Veneciane).
2. Ky kufizim do të jetë gjatë orarit 18:00 – 23:00. Gjatë këtij orari ndalohet parkimi i mjeteve përgjatë rrugës Epidamn.
3. Ndërmarrja Rruga duhet të vendosë sinjalistikën e përcaktuar në këtë Urdhër brenda 2 ditëve.
4. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Ndërmarrja Rruga, Policia Bashkiake.

ZËVENDESKRYETAR
Gentian Kallmi

